

## Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DELVINË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**  
**Komisioni i Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes Sociale**

### RAPORT VENDIMMARRJEJE

Nr. \_\_\_ datë 30.03.2026

**Drejtuar:** Këshillit të Bashkisë Delvinë

**Lenda:** Vendim për shqyrtimin e projektvendimit nr. \_\_\_ datë \_\_\_\_\_2026, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-28 shkurt 2026”.

#### **Analiza ligjore:**

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 57/2019, datë 18.07.2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të VKM nr.617, datë 22.09.2022 për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.579, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit shtesë mbi fondin e kushtëzuar të ndihmës ekonomike” si edhe Rregullores se Funkcionimit te Keshillit bashkiak.

#### **Situata aktuale e funksionit** (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Përfitojnë ndihmë ekonomike në total nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri në 6% për muajin janar 2026 gjithësej 9 familje, me një fond 37888 lekë, të cilat janë skualifikuar nga sistemi për pikë të pamjaftueshme si edhe bazuar në kriteret e ndihmës ekonomike.

#### **Situata financiare:** (Shtesa / pakësime në buxhet)

Për banorët e qendrës së bashkisë Delvinë familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllokndihmën deri në 6%, për muajin shkurt janë 8 familje më një fond 34742 leke. Ndërsa për banorët e Njesisë administrative Vergo është vetëm një familje me një fond 3146 lekë.

#### **Drejtoria / Sektori përgjegjës**

Drejtoria e Financës, Shërbimit social dhe shëndetësor, Arsimit, Kulturës, Sportit, në bashkinë Delvinë.

#### **Monitorimi dhe raportimi:**

Drejtoria e Financës, Shërbimit social dhe shëndetësor, Arsimit, Kulturës, Sportit, në bashkinë Delvinë raporton disa herë në vit, sipas problematikës.

**Impakti social / grupet që preken:**

Familjet në kushte të vështira jetësore dhe pamundësi ekonomike.

Komisioni i Përhershëm, i mbledhur më datën 30.03.2026, shqyrtoi projektvendimin, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për dhënie e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën shkurt 2026, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

**VENDOSI**

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:  
Miratimin e projektaktit

**Erinda Seitaj**  
(emri, mbiemri, firma)

**Roza Gjikhima**  
(emri, mbiemri, firma)

**Kryetare e Komisionit**

**Sekretare e Komisionit**

## Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DELVINË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**  
**Komisioni i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare dhe Buxhetit**

### RAPORT VENDIMMARRJEJE

Nr. \_\_\_ datë 30. 03. 2026

**Lënda:** Vendim i Komisionit për projektvendimin “Për miratimin e Tavanëve Përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor të Bashkisë Delvinë për periudhën 2027 - 2029”, shoqëruar nga relacioni dhe dokumentet shoqëruese, të mbledhjes së këshillit bashkiak Delvinë.

#### **Analiza ligjore:**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 54, pika “dh”, Ligjit Nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” të ndryshuar, Ligjit nr.57/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9936, date 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.23, date 30.07.2018 “Për procedurat standarte të Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.7 datë 27.02.2026 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2027.-2029”, si edhe Rregullores së funksionimit të këshillit bashkiak, Delvinë.

#### **Situata aktuale e funksionit:**

1. Miratimin e Tavanëve Përgatitore të përgatitjes të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm të Bashkisë Delvinë për periudhën 2027-2029, sa më poshtë vijon:
  - Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme
    - Viti 2027 rritje 3,3 % krahasuar me vitin 2026 në vlerë 133.200.000 lekë
    - Viti 2028 rritje 4,2. % krahasuar me vitin 2027 në vlerë 138.815.000 lekë
    - Viti 2029 rritje 4,07% krahasuar me vitin 2028 në vlerë 144.465.000 lekë
  - Të ardhurat e veta
    - Viti 2027 rritje 0,74% krahasuar me vitin 2026, në vlerë 57.763.000 lekë
    - Viti 2028 rritje 1.7 % krahasuar me vitin 2027, në vlerë 57.863.000 lekë
    - Viti 2029 rritje 0.01 % krahasuar me vitin 2028, në vlerë 57.925.000 lekë
  - Transferta e pakushtëzuar sektoriale

Në nivelin e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për periudhën 2027-2029 janë marrë parasysh parashikimet për vitet 2027-2029, bazuar në kurset e këmbimit për vitet 2021-2025 si dhe Kuadri Makroekonomik e Fiskal sipas shtojcë Nr.3 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.7, datë 27.02.2026 .
  - Transferta e pakushtëzuar sektoriale.
    - Viti 2027 rritje 2 % krahasuar me vitin 2026 në vlerë 88.484.000 lekë
    - Viti 2028 rritje 0 % krahasuar me vitin 2027 në vlerë 88.484.000 lekë
    - Viti 2029 rritje 1 % krahasuar me vitin 2028 në vlerë 89.369.000 lekë

#### **Situata financiare:**

Situata financiare paraqitet sipas tabelave bashkëlidhur.

#### **Drejtoria/Spektori përgjegjës:**

Drejtoria Ekonomike.

#### **Impakti social/grupet që preken:**

Të gjithë qytetarët e bashkisë së Delvinës.

***A është objekt i konsultimit publik?***

Është objekt i konsultimit publik. Dhe seanca përkatëse u zhvillua në sallën e keshillit bashkiak, në bashkinë Delvinë, sipas dates dhe kalendarit të njoftimit publik.

Komisioni i përhershëm për Ekonominë dhe Financën, i mbledhur më datë 30.03.2026, shqyrtoi projektvendimin, si edhe relacionin dhe dokumentet shoqëruese të tij.

Pas shqyrtimit të projektvendimit dhe materialeve shoqëruese, komisioni me shumicë votash, vendosi:


***T'i propozojë Keshillit bashkiak:***

a- *Miratimin e projektit*

\_\_\_\_ Paola Boci

 Kryetar i komisionit

\_\_\_\_ Skerdian Mehmeti

 Sekretar i komisionit